

VENDIM
Nr.676, datë 21.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA QENDËR (FIER), TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Qendër (Fier), të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 9 (nëntë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër (Fier) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE										
Komuna: Qendër (Fier)										
Fusha e përdorimit të pronës: pyje+kullota										
Nr.	Nr i inv.	Emërtesa e ekonomisë pyjore/kullosore	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërimit popullor)	Nr. i ngas.	Destinacioni	Sip. në ha.	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	307	Ek. Pyjore Seman 1	Daullasi	14/a	Pyll	2.72	Prodhues	M M P A U	D SH P	
2	308	"	Pylli Grecalli	14/b	"	7.8	"	"	"	
3	309	"	Pylli matkes	15	"	6.3	"	"	"	
4	310	"	Argj.nikas	16/a	"	1.1	"	"	"	
5	311	"	Argj.nikas	16/b	"	8.3	"	"	"	
6	312	"	Argj.nikas	16/c	"	9.2	"	"	"	
7	313	"	Argj.nikas	16/d	"	5	"	"	"	
8	314	"	Argj.nikas	16/d	"	40.42	"	"	"	
9	315	"	Fidanishte Bishanak	16	"	41	"	"	"	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
307 -315	Pyll	Në pronësi